# DËSHMI ARKIVI

**A-430867**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Skandal korrupsioni në Ukrainë, dorëhiqet Prokurori i Përgjithshëm – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/skandal-korrupsioni-ne-ukraine-dorehiqet-prokurori-i-pergjithshem/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 8 shtator 2026, 22:24:58 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 8 shtator 2026, 18:10:31 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `687c5a230a42cb62dacbaa77171cca614d93990882e18b2efffb65855b880492` |
| TEKSTI | `5a00c0e12ebb6f4794876573987785517c6e86527d76fc12faeddbb0c3c59f71` |
| PAMJA | `7bb7b85c69176ab0d947b77e67a95d4c9147bb8e4ba912349ed426b5de0175c0` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `66156c0500f74ce8dab7082b7717552985fcca6f6944ef6132660184bbfa2c7f` |
| E MËPARSHMJA | `4d3c8ea90af6a6003cb20de56832d08b5b0f7736c076ac62d85291a66b5d22e7` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/66156c0500f74ce8dab7082b7717552985fcca6f6944ef6132660184bbfa2c7f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

5 Soreca: Zëri i të rinjve duhet të dëgjohet, janë e ardhmja e Shqipërisë

Vendimi vjen pak ditë pasi hetuesit e Byrosë Kombëtare Antikorrupsion të Ukrainës (NABU) dhe Prokurorisë së Posaçme Antikorrupsion (SAP) kryen kontrolle në zyrat e Prokurorisë së Përgjithshme.

Sipas autoriteteve hetimore, një zyrtar i lartë i Prokurorisë së Përgjithshme dyshohet se drejtonte një skemë për pastrimin e parave, ndërsa ofronte mbrojtje për qendra të paligjshme mashtrimi telefonik në këmbim të pagesave.

Hetuesit bëjnë me dije se paratë e përfituara nga aktiviteti kriminal dyshohet se janë përdorur për blerjen e pasurive të paluajtshme, bizhuterive dhe sendeve të tjera me vlerë. Bëhet fjalë për miliona në asete që dyshohet se janë pastruar përmes kësaj skeme.

Kravçenko i ka mohuar akuzat, duke i cilësuar ato si “plotësisht të pabazuara”. Në letrën e dorëheqjes, ai deklaroi se nuk dëshiron që posti i Prokurorit të Përgjithshëm të përdoret si “mjet për përballje politike”.

Pas dorëheqjes, Kravçenko falënderoi presidentin Volodimir Zelenski dhe Parlamentin ukrainas për besimin e dhënë ndaj tij. Deri tani, presidenti ukrainas nuk ka bërë një reagim publik lidhur me dorëheqjen.

Rasti rikthen në vëmendje problemin e korrupsionit në Ukrainë, një çështje që ka shkaktuar debate të forta edhe gjatë luftës me Rusinë.

NABU dhe SAP, dy institucionet kryesore të vendit në luftën kundër korrupsionit, kanë qenë në qendër të përplasjeve politike edhe vitin e

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu


kaluar, kur planet për kufizimin e pavarësisë së tyre shkaktuan protesta dhe shqetësim nga partnerët europianë të Kievit.

Pas reagimeve të forta, Zelenski tërhoqi ndryshimet dhe riktheu pavarësinë e institucioneve antikorrupsion. Megjithatë, hetimet e fundit tregojnë se korrupsioni vijon të mbetet një nga sfidat më të mëdha për autoritetet ukrainase.

#Korrupsion #Skandal #Ukraine #VizionPlus

**Taulant Halili**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.
Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh

BOTA
**Tragjedi! Përmbyset anija me pasagjerë,...**
Xhuljana Zhuleku — Dje 23:17

BOTA
**Zjarr masiv në Kroaci, evakuohen 230...**
Xhuljana Zhuleku — Dje 19:36

BOTA
**Trump: Lufta me Iranin do të...**
Xhuljana Zhuleku — Dje 18:51

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE

**Lajme**
Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

**Programe**
Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara
vizionplus.tv
Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.